



Shkollat Publike të Uorsterit

Uorster, Masaçusets



Zyra e Përgjegjësit
Maureen F. Binienda
Përgjegjëse

Dr. John E. Durkin Administration Building
20 Irving Street
Uorster, Masaçusets 01609-2493

Tel. (508) 799-3115
FAX (508) 799-3119
biniendam@worc.k12.ma.us

22 shtator 2016

Të dashur prindër/kujdestarë,

Më 26 prill 2016, Guvernatori Charlie Baker dhe Ministri i Financave të Shtetit, Deb Goldberg, njoftuan se nga Fondi për Ujë të Pastër i Masaçusets (MCWT) do të përdoren 2 milionë dollarë për financimin e përpjekjeve të përbashkëta për të ndihmuar në testimin e ujit të pijshëm në shkollat publike të Masaçusets për sa i përket pranisë së plumbit dhe bakrit. Fondet, të cilat do të përdoren nga Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit në Masaçusets (MassDEP), do të sigurojnë ndihmë teknike për të garantuar që drejtoritë e shkollave publike të mund të analizojnë rubinetët dhe çezmat në shkollat e tyre e të identifikojnë çdo rezultat që tregon ndotje nga plumbi dhe bakri mbi nivelin e lejuar.

Shkollat Publike në Uorster aplikuan dhe u përzgjedhën për të marrë pjesë në këtë program vullnetar. Të gjitha shkollat do të marrin pjesë në këtë program.

Programi përfshin mbledhjen e një numri disi të madh kampionësh nga të gjitha rubinetët, çezmat dhe pajisjet e përdorura për të pirë ujë dhe për të përgatitur ushqimin e pijet në secilën prej këtyre shkollave. Do të merren dy kampionë në secilën pajisje në këto shkolla, të cilët do të dërgohen në laborator për analiza. Pasi rezultatet t'i jenë dhënë drejtorisë do të njoftohet komuniteti, dhe çdo ndihmë teknike e nevojshme do t'i jepet drejtorisë nga MassDEP. Gjithashtu, sipas nevojës ne do të punojmë ngushtë me Divizionin e Shëndetit Publik të qytetit dhe me njësinë e Inspektimit të Sistemit Hidraulik të Departamentit të Shërbimeve të Inspektiveve.

Mbledhja e kampionëve në shkolla duhet bërë kur godina është e mbushur me njerëz, por rubinetët nga ku do të mbledhen kampionët duhet të jenë të papërdorur për të paktën gjashtë orë (por jo më tepër se tetëmbëdhjetë orë). Pritet që këta kampionë të merren në shkolla herët në mëngjes gjatë disa muajve vijues.

Më shumë informacion për Programin e Ndhmës kundër Plumbit në Ujin e Pijshëm në Shkolla mund të gjendet në adresën <http://www.mass.gov/eea/agencies/massdep/water/drinking/testing-assistance-for-lead-in-school-drinking-water.html>

Kur të kemi një raport përfundimtar për rezultatet e analizave të ujit, do t'ju dërgoj një njoftim të përditësuar.

Me respekt,

Maureen Binienda
Përgjegjëse



Worcester Public Schools

Worcester, Massachusetts



Office of the Superintendent
Maureen F. Binienda
Superintendent

Dr. John E. Durkin Administration Building
20 Irving Street
Worcester, Massachusetts 01609-2493

Tel. (508) 799-3115
FAX (508) 799-3119
biniendam@worc.k12.ma.us

September 22, 2016

Dear Parents/Guardians,

On April 26, 2016, Governor Charlie Baker and State Treasurer Deb Goldberg announced that \$2 million from the Massachusetts Clean Water Trust (MCWT) will fund cooperative efforts to help Massachusetts public schools test for lead and copper in drinking water. The funds, to be used by the Massachusetts Department of Environmental Protection (MassDEP), will provide technical assistance to ensure that public school districts can sample the taps and water fountains in their schools, and to identify any results that show lead and copper contamination over the action level.

The Worcester Public Schools applied for and was selected to participate in this voluntary program. All schools will participate in this program.

The program consists of a fairly extensive sample of all taps, faucets, and fixtures used for drinking water and food & beverage preparation in each of these schools. Two samples will be taken in each fixture at these schools and sent to a laboratory for analysis. Once the results are provided to the district, the community will be notified and any necessary technical assistance will be provided to the district by MassDEP. We will also work closely with the city's Division of Public Health and the city's Plumbing Inspection unit of Department of Inspectional Services as may be necessary.

Sampling in schools must occur when the building is in full occupancy but taps being sampled should be inactive for at least six hours (but no more than eighteen hours). It is expected that these samples will be taken at the schools in the early mornings during the next several months.

More information about the Assistance Program for Lead in School Drinking Water program can be found at <http://www.mass.gov/eea/agencies/massdep/water/drinking/testing-assistance-for-lead-in-school-drinking-water.html>

Once we have a final report on the results of the water testing I will send you an updated notice.

Sincerely,

Maureen Binienda
Superintendent